

AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ LISAC “ shpk

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ,Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare sot me date 21/08/2020, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin“LISAC“ shpk

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Koberzgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “LISAC “SHPK.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria “LISAC “ shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga nga ortaku i vetem, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne fshatin Mbrostar-Ura, Komuna Mbrostar ” ,Qendra Tregtare Viva, zona kadastrale Nr.2636, Nr I pasurise 101/36.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria “LISAC” shpk., ka per objekt kryerjen e cdo aktiviteti te lejuar me ligj dhe/ ose pjesemarrje ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe,

ne vecanti :

Import eksport me shumice dhe pakice te materialeve elektrike te mallrave te ndryshme industriale,



instalime elektrike, elektronike, aksesore te ndryshem , vegla pune etj  
Import eksport me shumce dhe pakice te sistemeve te kondicionim ventimilit , te sistemeve te ngrohjes ,kaldajave etj .  
Prodhim dhe tregetim te artikujve te ndryshem mobilerie, dyer, dritare, artikuj duralumini, tregetim paisje zyre, kanceleri, paisje ventilimi dhe kondicionimi,kundra zjarrit.  
Tregetim paisje hidraulike, paisje hidrosanitare dhe aksesore te tyre.  
Prodhim, fabrikim dhe tregetim te materialeve te ndertimit, inerte, prodhimeve te betonit etj,  
Sherbime te punimeve mekanike, ngrohje, kondicionim dhe hidrantit kundra zjarrit  
Dhenie me qera, administrimin dhe mirembajtje ambjentesh tregtare, dyqanesh dhe qendra tregtare.  
Restorant, piceri, bar-kafe, kende lojrash per femije.  
Transport udhetaresh brenda dhe jashte qyteti. Sherbim transporti urban.

#### Neni 5

##### Kobezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

## KREU II KAPITALI

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga “ortaku i vetem “ i shoqerise

**Ortaku Themelues: Bashkim Malasi** , zoterues i 1 (nje ) kuote , me vlere te pergjithshme 100 Leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pasi te dali NIPTI i shoqerise .

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.





Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMARRRESE DHE DREJTUESE**

#### Neni 8

##### Organi Vendimarrës

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimarrës i shoqërisë. Ortaku i Vetem është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë “ LISAC “ shpk është z. Bashkim Malasi , atesia Shahin, I datelindjes 01/08/1944 , lindur në Gllave Tepelene e banues në Fier, shtetas shqiptar, me Nr Personal: E40801016A , i cili do të ushtroje funksionet në këto detyre për një periudhë 5 vjetore me të drejtë ripërteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë.



## Neni 10

### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 11

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## Neni 12

### Prishja dhe likuidimi





Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

### Neni 13

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

### Neni 14

#### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 15

#### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “ LISAC “ shpk, dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

**Bashkim Malasi**

*Bashkim Malasi*

